



**POLICY
ANSWERS**

SHKURTIMISHT PËR: BURIMET UJORE NË KOSOVË

Responsible organisation: Riinvest
Institute

Date: February 2023



<https://www.facebook.com/WBInfoHub>



<https://x.com/wbinfohub>



<https://www.linkedin.com/company/wbinfohub/>

www.westernbalkans-infohub.eu

POLICY ANSWERS is funded by the European Commission through the Horizon Europe project "R&I POLICY making, implementation ANd Support in the WEsteRn BalkanS", Grant Agreement N° 10105887.



**Funded by
the European Union**

HYRJE¹

Në kohën kur bota po ballafaqohet me pasojat në rritje të ngrohjes globale dhe me trendin në vijim të rritjes së popullsisë në nivel global, po bëhet gjithnjë e më shqetësues rënia e pritur e nivelit të burimeve ujore për 20 përqind deri me 2040. Ndërlidhur me këtë kontekst global gjendja në Kosovë, duket edhe më alarmante nisur nga fakti se është vendi më i thatë në Evropë sa i përket burimeve ujore². Kosova ka rreth 16 përqind të mesatares të disponueshmërisë të ujërave për kokë banori në vit krahasuar me rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në Kosovë akumulohen 42 përqind më pak të reshura të ujit krahasuar me mesataren e shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Kosova, sipas vlerësimeve është e listuar ndër vendet me rrezik të stresit ujor, pra, me mungesa të ujit në situatë ku qytetarët kanë nevojë më së shumti, periudhat e verës. Dhe kjo është karakteristikë sidomos në pjesët lindore dhe verilindore të vendit. Vendi ynë gjithashtu është një vend tranzit sa i përket burimeve ujore, ku ujërat kalojnë përmes Kosovës dhe rrjedhin në tri detëra të ndryshme: Deti i Zi përmes territorit të Serbisë, Deti Adriatik përmes territorit të Shqipërisë, Deti Egje përmes territorit të Maqedonisë së Veriut. Dhe, sipas vlerësimeve vetëm 10 përqind të këtyre ujërave mbesin në Kosovë.

Si faktor që ka ndikuar në këtë gjendje është karakteri tranzit i burimeve ujore në Kosovë. Kësaj i shtohet edhe mosmirëmbajtja dhe dëmtimi përkatësisht i ujërave sipërfaqësore, ngecja me investime në ujëra nëntokësore dhe investimet e munguara disa dekada në akumulimet dhe rezervarët ujore. Akumulimet ujore artificiale në të cilat ka investuar Kosova më herët të shumtën në vitet e 1960 –1985 si Ujmani, Batllava, Badovci dhe Radoniqi, kapaciteti i të cilave është 563.6 milion m³, kur krahasohen me mesataren evropiane ose rajonale pasqyrojnë faktin se disponimi me ujë është një nga faktorët primar limites të zhvillimit afatgjatë të Kosovës.

Andaj, duke parë sfidat që Kosova ka në kontekstin e Burimeve Ujore, në kuadër të aktiviteteve të rregullta avokuese, Instituti Riinvest përmes platformës Green Action Space në fund të muajit Janar ka organizuar një diskutim në panel ku janë trajtuar në mënyrë të thelluar Burimet Ujore në Kosovë dhe sfidat dhe mundësitë që Kosova i ka. Ky dokument përmbledh shkurtimisht disa nga çështjet kryesore që janë trajtuar në këtë diskutim.

SFIDAT DHE MUNDËSITË ZHVILLIMORE

Institucionet e Kosovës kanë adoptuar ligje dhe strategji sa i përket burimeve ujore dhe ujërave në Kosovë me qëllim që të adresohen sfidat që Kosova aktualisht ballafaqohet dhe atyre në të ardhmen. Përmes Strategjisë Nacionale për Ujërat 2017-2036, Qeveria e Kosovës ka për qëllim t'i adresoj dhe të krijojë një bazë të mirë veprimi në aspektin e politikave, veprimeve operacionale dhe investimeve në sektorin e ujërave në një periudhë 20 vjeçare. Me këtë dokument synohet një integrim dhe zhvillim i qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të ujërave në Kosovë si : furnizimi me ujë të pijshëm, uji për prodhimin e ushqimit, ujitja e tokës bujqësore, industria, sporti dhe rekreacioni, dhe prodhimi i energjisë elektrike. Ndër të tjera parashihet dhe ruajtja, mbrojtja e burimeve ujore, valorizimi ekonomik i burimeve ujore aktuale, përmes menaxhimit më efikas, dhe përfitimi nga këto burime. Institucionet relevante marrin mbi vete përgjegjësinë t'i adresojnë dhe

¹ Publikuar nga Instituti Riinvest. Ky dokument është nxjerrë nga seria e debateve 'Green Talks' në kuadër të platformës Green Action Space, iniciativë e përbashkët e Institutit Riinvest dhe fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja e këtij publikimi janë përgjegjësi e Institutit Riinvest.

² Water Security Outlook for Kosovo (2018). Washington, D.C.: World Bank Group.

sfidat që Kosova i ka që përshijnë dhe trajtimin e ujërave të ndotura përmes projekteve për ndërtimin e impianteve për grumbullimin e ujërave të zeza.³

Kosova është e ekspozuar nga vërshimet si rezultat i ndotjes të lumenjve nga mbeturinat dhe eksploatimi i shtretërve të lumenjve. Strategjia po ashtu synon që të parandalojë degradimin e resurseve ujore ndër vite, si pasojë e eksploatimit të egër të lumenjve, dëmtimi i shtretërve të lumenjve dhe shkarkimit të ujërave industriale dhe ujërave fekale të amvisërisë. Po ashtu, në kuadër të këtyre sfidave është mungesa e mirëkuptimit të institucioneve sa i përket rëndësisë dhe urgjencës që Kosova ka sa i përket burimeve ujore dhe urgjencës për të intervenuar përmes mekanizmave institucional. Në këtë kontekst, Kosova nuk ka një plan të përditësuar sa i përket burimeve ujore, operon me planin e viteve të 80'ta. Arsyeja se këto plane duhet të përditësohen ndërlidhet me dyndjet demografike, ndryshimet urbane dhe ndryshimet klimatike. Dinamika e ndryshimeve klimatike dhe të dhënat hidrometeorologjike që ndryshojnë vazhdimisht për shkak të ndryshimeve klimatike, kanë ngritur urgjencën që të përditësohen planet e operimit dhe reagimeve sa i përket burimeve ujore. Për këtë arsye Bashkimi Evropian ka rekomanduar që të ketë një përditësim në një cikël gjashtë vjeçar.

Në kuptimin e legjislacionit, strategjive dhe politikave ekziston një infrastrukturë e mirë në sektorin e ujërave. Megjithatë, zbatimi i ligjeve dhe strategjive më saktësisht i strategjisë nacionale për ujërat edhe pas pesë viteve të rishikimit të saj mbetet një sfidë që ndërlidhet me disa arsye: E para, fokusi ende mbetet tek konsolidimi i institucioneve. Një nga sfidat më të rëndësishme është mungesa e burimeve njerëzore që ndikon në zbatimin e ligjeve dhe strategjive në mënyrë efikase. E dyta, në strategjinë aktuale të burimeve ujore bazuar në ligj parashihet që Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore të jetë agjenci ekzekutive, obligim ligjor i cili nuk është zbatuar. Të gjithë hapat e lartë përmendur janë hapat fillestar të përmbajtur në Strategji, por nuk janë adresuar dhe mbeten aktuale edhe pas rishikimit pesë vjeçar të strategjisë.

Kosova duhet të ndërtojë një qasje dhe filozofi të re zhvillimore sa i përket ekonomisë ujore. Kjo jo vetëm investimet strategjike në zhvillimin e resurseve të reja- që të shumtën ndërlidhen me akumulimet e reja, por edhe investimeve në zhvillimin e shërbimeve ujore. Fokusi i qeverisë duhet të jetë një master-plan i përditësuar, ngase ende vendi shërbehet me master-planin e viteve 80'ta. Janë bërë studime të fizibilitetit për ndërtimin e digave për t'i furnizuar qytetet e mëdha me ujë të pijshëm. Këto studime të fizibilitetit priten të përfundojnë brenda vitit 2023, në mënyrë që të fillojë procesi i tenderimit për ndërtimin e digave në vitin 2024. Në kuadër të kësaj, kanë filluar të bëhen studime të fizibilitetit të tri projekteve/digave tjera. Fokusi është përqendruar edhe në shërbimet ujore. Shërbimet ujore përfshijnë menaxhimin dhe operimin e ujësjellësit, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Qeveritë viteve të fundit janë duke i dhënë rëndësi trajtimit të ujërave të ndotura përmes investimeve në projekte në qytete të ndryshme të Kosovës. Në këtë kontekst, është dhënë një vlerësim pozitiv në raportin e progresit të Bashkimit Evropian ku Kosova ka arritur të ketë një progres sa i përket monitorimit të ujërave nëntokësore dhe investimeve që janë bërë në trajtimin e ujërave të zeza. Vlen të theksohet se përkundër mungesës së një fokusi më të përqendruar në intervenime konkrete nga ana e qeverisë së Kosovës, dhe përkundër ndryshimit të shpeshtë të qeverive, projektet aktive sa i përket burimeve ujore kanë vazhduar të zbatohen.

Roli i donatorëve në kontekstin e burimeve ujore ka qenë kyç në vitet e pasluftës. Deri në vitet e fundit, donatorët kanë qenë bartës të aktiviteteve qenësore, ndërsa tani më shumë i përgjigjen

³ Në këtë diskutim në panel, diskutimi është fokusuar në sfidat që Kosova i ka sa i përket Burimeve Ujore në Kosovë dhe masave potenciale që Institucionet relevante duhet të marrin. Të ftuar për të diskutuar në panel ishin znj. Fatlije Buza, përfaqësuese nga Ministria e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor (TK), z. Baton Begolli-Këshilltar-Këshilli Ndërmnistror për Ujërat (KNMU), si dhe z. Zeqir Veselaj, Profesor në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës.

kërkesave të institucioneve dhe ndërmjet institucioneve dhe donatorëve është ndërtuar një bashkëveprim. Me donatorët, në vitet e fundit është kaluar nga faza e granteve në bashkëfinancim, dhe analizën e qëndrueshmërisë së projekteve. Megjithatë, roli dhe ndikimi i donatorëve sidomos tek asistenca teknike nuk ka qene sa duhet efektiv për shkak të mungesave të kapaciteteve absorbuese të institucioneve. Po ashtu, marrja e kredive vlerësohet se nuk është e favorshme për të bërë investime strategjike. Kjo sipas vlerësimeve është kushtëzimi që bëhet nga ana e kreditorëve dhe kostoja përbën në vetvete kredinë. Andaj, në vitet e fundit ka një vetëdijesim institucional dhe vëmendja është fokusuar tek kombinimi i donacioneve me fokus në fusha prioritare dhe financim nga ana e institucioneve të qeverisë në nivel qendror dhe lokal.

REKOMANDIME

Në vijim janë paraqitur disa rekomandime që derivojnë nga diskutimi me ekspertët në kuadër të diskutimit për Burimet Ujore në Kosovë:

- Është i nevojshëm rishikimi sa më i shpejtë pesë vjeçar i strategjisë ekzistues dhe përditësimi i saj. Sidomos duhet të përditësohet master-plani i viteve të 80'ta dhe të harmonizohet duke u bazuar në ndryshimet socio-demografike dhe zhvillimin urban në Kosovë dhe shoqërohet me një plan investimesh dhe aktivitete përcjellëse për përgatitjen me kohë të projekteve (studimeve, burimeve të financimit dhe menaxhimit të realizimit të projekteve).
- Strategjia Nacionale për Ujërat të fokusohet jo vetëm në krijimin e rezervave ujore, por edhe mbrojtjen e burimeve aktuale ujore në Kosovë.
- Të ndërtohen kapacitetet institucionale të institucioneve relevante për të siguruar funksionalizim dhe monitorim të implementimit të strategjisë dhe ligjeve sa i përket burimeve ujore, të vendoset prioritet. Të analizohet arsyeshmëria e themelimit të Autoriteteve Rajonale të Pellgjeve Lumore si agjenci ekzekutive.
- Përmes rishikimit pesëvjeçar të strategjisë nacionale për ujërat të orientohet në veprime konkrete siç janë: ndalimi i shkarkimit të ujërave të ndotura nga ana e industrisë dhe ndalimi i eksploatimit të lumenjve.
- Përmes avokimit të shoqërisë civile në bashkëpunim me të gjitha institucionet e qeverisë në nivel qendror dhe lokal dhe mediave, të këtë përfshirje më aktive të qytetarëve dhe sektorit privat për të ngritur vetëdijen sa i përket rëndësisë të burimeve ujore dhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.